

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: SHËRBIME, MATERIALE PROMOCIONI PËR
AGJENCINË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): **79342200-5;
39294100-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 16,145,866.66 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose 164,301.07 (njëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e treqind e një pikë zero shtatë) Euro pa tvsh.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (98.27), datë 04.11.2024, ora: 12:31.)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiros minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë të punësuar, profesionistët e mëposhtëm:

- a) 1 (një) punonjës Fotograf
- b) 2 (dy) punonjës Videograf
- c) 1 (një) punonjës Teknik Audio
- d) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- e) 1 (një) punonjës Përkthyes i gjuhës angleze
- f) 1 (një) punonjës Specialist Marketingu
- g) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- h) 1 (një) punonjës Koordinator logjistike

Për punonjësin në pikën a, b, c, d duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit, fotografisë, videografisë, teknikë audio;
- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil

Për punonjësin në pikën e) duhet të paraqitet:

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
- liçencë përkthimi në gjuhën angleze (të vlefshme), e lëshuar nga organet kompetente

Për punonjësin në pikën f, g, h) duhet të paraqitet:

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike dhe shërbimeve që duhet të realizojë ofertuesi, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Përgjegjësi i shërbimit ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Përgjegjësi i shërbimit planifikon dhe ndjek zbatimin e çdo faze të objektit të prokurimit, koordinon punën me punonjësit e tjerë të përfshirë, dhe siguron që të gjitha aktivitetet të përputhen me objektivat e AK.

Koordinatori i logjistikës ndihmon në zgjedhjen dhe menaxhimin efektiv të sallave, duke marrë në konsideratë numrin e pjesëmarrësve, kërkesat specifike të eventit dhe shërbimet e tjera ndihmëse. Koordinatori siguron që salla të jenë në përputhje me standartet e eventit, përfshirë pajisjet audio vizuale, aksesin dhe ambientin e duhur, ushqimet, siguron që çdo element i logjistikës të jetë sipas standarteve të kërkuara për promovimin. Koordinatori i logjistikës koordinon të gjitha detajet teknike dhe operationale, menaxhon situatat që mund të ndodhin duke minimizuar ndikimin e tyre në event.

Specialist Marketingu vlerësohet i nevojshëm për krijimin dhe zhvillimin e strategjive të marketingut për promovimin e objektit të prokurimit, krijimin e kontetit për të gjitha aktivitetet e AMVV.

Fotografi është përgjegjës për fotografimin e momenteve të rëndësishme gjatë eventit dhe përgatitjen e fotografive me cilësi të lartë, duke shkrepur momente që pasqyrojnë qartë mesazhin e eventit. Fotografi gjithashtu do të kryejë edhe detyrën e përpunimit e fotografive, për të siguruar cilësi vizuale dhe harmonizim me mesazhin e eventit.

Videografi është përgjegjës për regjistrimin e videove, që përmbledhin eventin apo promovojnë objektin e prokurimit, menaxhon ndriçimin, hartimin e skenarit dhe planit të xhirimeve dhe siguron që cilësia e videos të jetë profesionale dhe e përshtatur me qëllimin promociional, si dhe sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK. Videografi gjithashtu do të kryejë edhe detyrën e redaktimit të materialeve të xhiruara, përfshirë përmirësimin e cilësisë së zërit dhe imazhit, si dhe integrimin e grafikëve.

Teknik Audio është përgjegjës për vendosjen dhe konfigurimin e kamerave, mikrofonave, ndriçimit dhe çdo pajisje tjetër teknike që nevojitet për xhirime dhe prodhim video. Funkcioni dhe prezenca e punonjësit “Teknik audio” është e nevojshme, pasi parandalon çështjet teknike gjatë regjistrimit dhe prodhimit të përmbajtjes, siguron cilësinë e zërit.

Grafik dizanjer është përgjegjës për krijimin e elementëve vizualë dhe integrimin e grafikëve në materialet e regjistruara, si dhe materialet si stilolapsa, rrol up, çanta, blloqe, kartëvizita, badge,

dosje me logo, kalendar etj., objekt prokurimi, duke siguruar që identiteti vizual të jetë i qartë, tërheqës dhe i përshtatshëm për materialet promovionale, në përpruthje me standartet dhe kërkesat e AK.

Referuar specifikimeve teknike, duke qenë se ndër detyrat e operatorit ekonomik është edhe sigurimi i përkthyesit të licënsuar të gjuhës angleze, është e nevojshme që ofertuesi të ketë pjesë të stafit të tij për realizimin e objektivit të prokurimit, edhe një përkthyes të gjuhës angleze.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës, të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë
- Makinë qepëse 2 (dy) copë
- Makinë telefoni; 2 (dy) cope
- 1 (një) paisje printer UV me bojëra rezistente për hapësira të jashtme me mundësi printimi deri në 5m gjerësi për roll up baner
- 1 (një) paisje printer për printim të materialeve promovionale dhe të personalizuar

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet për kryerjen e shërbimit të botimit, printimit dhe të gjitha proceseve të tij për artikujt si stilolapsa, blloqe, roll up, kartëvizita, kartolina, kalendar, manuale, raporte performance, etj. të përshkruara në specifikimet teknike.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe përmasa) është vendosur bazuar në specifikimet teknike, detyrat dhe proceset e kryerjes së shërbimit objekt prokurimi, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve objekt prokurimi, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti ose 2 (dy) mjete të kombinuara, për transportimin e të paktën 30 personave në adresat ku do të organizohen eventet.

Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të paktën një karrotrec për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se një ndër detyrat e operatorit ekonomik, me qëllim përmbushjen e objektit të kontratës është edhe realizimi i transportorit e të paktën 30 personave, në adresat e përcaktuara nga Ak, ku do të organizohen eventet, vlerësohet e nevojshme që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) mjet transporti ose 2 (dy) mjete të kombinuara, me qëllim përmbushjen e objektit të prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT